



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:129699

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644541

KPPP.nr.1908/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përmbarimore të kreditorit “Banka Ekonomike” me numër biznesi 80117029, me seli në Prishtinë, kundër debitorëve N.SH.T. “Ariani” SH.P.K. me numër biznesi 70084865 , me seli në Prishtinë, Zona Industriale, Magjistratja Prishtinë – Fushë Kosovë, e përfaqësuar nga U.D., sipas autorizimit e përfaqëson T.B. dhe Y.B., avokatë nga Gjakova, dhe U.D. me numër personal ... nga Gjakova, rr. “...” Nr.3, duke vendosur sipas prapësimit të debitorëve të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr. 163/22 të datës 12.04.2022 të lejuar nga Përmbaruesi Privat Gëzim Gjoshi me seli të zyrës në Gjakovë, 2023 me datë 30.04.2024, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si i pabazuar prapësimet e debitorëve N.SH.T. “Ariani” SH.P.K. dhe U.D., MBETET NË FUQI Urdhri Përmbarimor P.nr. 163/22 i datës 12.04.2022 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gëzim Gjoshi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Banka Ekonomike” ka lëshuar Urdhrit Përmbarimor P.nr.163/22 të datës 12.04.2022, me të cilin e ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues Marrëveshjes mbi Pengun Nr.248736 të datës 15.06.2020 dhe Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-20200619-90, Marrëveshjes mbi Pengun Nr.298982 të datës 25.02.2021 dhe Konfirmimi i regjistrimit të pengut r-20220404-101, Marrëveshjes mbi Pengun Nr.298979 të datës 25.02.2021 dhe Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-20220315-149, si dhe Kontratës mbi Hipotekën LRP.Nr.2018/2020 dhe LRP.Nr.Ref.392/2020 dhe Aktvendimit për Regjistrimin e Hipotekës Nr.Ref. 13168/20, duke detyruar debitorët që në afat prej 7 ditësh

t'ia paguaj kreditorit shumën prej 236,862.66€ (dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent), përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorëve nëpër të gjitha bankat komerciale si dhe sekuestrimi të pronës së paluajtshme të lënë në hipotekë e cila identifikohet me shenjën P-70705029-02573-3 me sipërfaqe prej 282m².

Debitorët brenda afatit ligjor, kanë paraqitur prapësimet e tyre përmes përfaqësuesve të autorizuar, duke e kundërshtuar në tërësi ligjshmërinë e urdhrin përmbarrimor. Debitori N.SH.T. "Ariani" ka kundërshtuar në tërësi borxhin ndaj kreditorit duke theksuar se borxhi i cekur në propozimin për përmbarrim nuk ekziston. Debitori U.D. përmes prapësimit po ashtu ka kundërshtuar ligjshmërinë e procedurës përmbarrimore si dhe obligimin në tërësi. Gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorëve dhe ta anuloj Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 163/22 të datës 12.04.2022.

Përgjigje në prapësim brenda afatit ligjor ka paraqitur kreditori, i cili ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar prapësimet e debitorëve duke shtuar se dokumentet në bazë të së cilave është iniciuar procedura përmbarrimore janë dokumente përmbarruese me titull ekzekutiv. Ka kundërshtuar se prapësimet janë ushtruar vetëm për zvarritjen e procedurës dhe gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi prapësimet e debitorëve si të pabazuara dhe të lënë në fuqi urdhrin përmbarrimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe vlerësimin të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi duke vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: "*Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*", ndërsa sipas nenit 5, par. 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore përcaktohet se dokument përmbarrues paraqet: "*...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...*", dhe nenit 22, par. 1.7 përcaktohet se "*1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit*".

Gjykata vlerësoi dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarrimi dhe gjeti se Marrëveshje mbi Pengun Nr.248736 E datës 15.06.2020 dhe Konfirmimi i regjistrimit të pengut

R-20200619-90, Marrëveshja mbi Pengun Nr.298982 të datës 25.02.2021 dhe Konfirmimi i regjistrimit të pengut r-20220404-101, Marrëveshja mbi Pengun Nr.298979 të datës 25.02.2021 dhe Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-20220315-149, i plotësojnë kushte për të qenë dokumente përmbare dhe janë titull ekzekutiv, pasi që të njëjtat janë paraqitur në kopje të noterizuara pranë noterit dhe atë Marrëveshja mbi Pengun Nr.248736 të datës 15.06.2020 është vërtetuar përmes aktit noterial LRP.nr.1602/2022 me datë 14.03.2022 nga noteri Burim Xhemajli si dhe në shkresa të lëndës është bashkangjitur Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-20200619-90, Marrëveshja mbi Pengun Nr.298982 të datës 25.02.2021 është vërtetuar përmes aktit noterial LRP.nr.1605/2022 me datë 14.03.2022 nga noteri Burim Xhemajli si dhe në shkresa të lëndës është bashkangjitur Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-20220404-101, si dhe Marrëveshja mbi Pengun Nr.298979 të datës 25.02.2021 është vërtetuar përmes aktit noterial LRP.nr.1607/2022 me datë 14.03.2022 nga noteri Burim Xhemajli si dhe në shkresa të lëndës është bashkangjitur Konfirmimi i regjistrimit të pengut R-20220315-149, janë paraqitur në formën e përcaktuar ligjore.

Po ashtu gjykata gjeti se Kontrata mbi Hipotekën, mbi bazën e së cilës është lejuar përmbaremi është paraqitur në formën e përcaktuar ligjore, pasi që Kontrata mbi Hipotekën LRP.Nr.2018/2020 dhe LRP.Nr.Ref.392/2020 e lidhur pranë zyrës noteriale të noteres Flutur R. Zajmi, është vërtetuar përmes aktit noterial LRP.Nr.Ref.1600/2022 me datë 14.03.2022 nga noteri Burim Xhemajli si dhe shkresave të lëndës i është bashkangjitur Aktvendimi për Regjistrimin e Hipotekës Nr.Ref. 13168/20.

Andaj, gjykata la në fuqi Urdhrin Përmbaremorë P.nr. 163/22 të datës 12.04.2022 të lejuar nga Përmbareuesi Privat Gëzim Gjoshi mbi bazën e dokumenteve përmbaremore të lartcekura, pasi që gjeti se dokumentet në bazë të së cilave është lejuar përmbaremi janë paraqitur në formën e kërkuar ligjore, në përputhje me nenin 38 par. 1 të LPP-së, se: *1. Propozimi për përmbaremi duhet ta përmbajë kërkesën për përmbaremi në të cilën do të tregohet dokumenti përmbaremor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbaremi, kërkuesi i përmbaremit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbaremi, objekti i përmbaremit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbaremit.*”, si dhe në përputhje me nenin 5, par. 2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore përcaktohet se dokument përmbareues paraqet: “...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin

zyrtar të pengut...”, dhe nenit 22, par. 1.7 përcaktohet se “1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit”.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1908/22, datë 30.04.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.